



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN
PUBLIC UNIVERSITY "KADRI ZEKA" GJILAN
Fakulteti Ekonomik - Faculty of Economics

Dekani: Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi

Datë: 22/09/2020

Informata për programet studimore të Fakultetit Ekonomik të UKZ

Të dashur kandidatë dhe ju të interesuar,

Besoj që deri tash e keni dëgjuar se momenti i zgjedhjes së profesionit është njëri nga dy momentet më vendimtare i cili do të ketë ndikim në të gjithë jetën tuaj. Për këtë arsye ju në radhë të parë duhet ta zgjidhni profesionin që e doni, e pastaj gjithë angazhimi tjetër do të jetë më i lehtë sepse do të jetë një punë që ju do të bënë me dëshirë dhe që do të ju jep kënaqësi, si në rastet kur përgatisni provime po ashtu edhe kur të punësoheni.

Në mënyrë që mos të bëhen gabime në këtë fazë që do të kenë pasoja në të ardhmen, ju duhet që të bëni analizat e të gjitha alternativave që keni para vetes për ta zgjedhur alternativën më të mirë.

Zgjedhja në mesin e shumë alternativave është njëra nga sfidat më të mëdha dhe është subjekt i shumicës së lëndëve në Fakultetin Ekonomik.

Për t'iu ndihmuar që në këtë fazë delikate që ju të bëni zgjedhjen më të mirë (më të arsyeshme), si Fakultet Ekonomik, po ju japim disa sqarime shtesë në lidhje me mundësitë që ofrojmë ne dhe programet tona. Kjo edhe për arsyen se sivjet fillojmë me dy profile të reja që nuk kanë qenë më parë dhe keni mungesë të informata.

Pra në Fakultetin Ekonomik sivjet pranohen studentë në Programin Banka Financa dhe Kontabilitet, dhe në Programin e ri, Menaxhim dhe Ndërmarrësi i cili ndahet në dy profile: Menaxhim dhe Ndërmarrësi si dhe Menaxhim i Marketingut dhe Shitjes.

Programi Banka Financa dhe Kontabilitet ekziston që nga fillimi në Fakultetin Ekonomik, i cili përgatitë studentët për punë në banka dhe institucione të tjera financiare e po ashtu edhe për kontabilitet. Është program që përgatitë studentët për tu punësuar si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Përmbajtjen e programit mund ta gjeni në këtë link: <https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2017/06/Programi-i-studimit-Banka-Financa-Kontabilitet-2017-18-deri-2019-20-1.pdf>

Programi Menaxhim dhe Ndërmarrësi ka një tjetër organizim pasi ai ka dy vitet e para të përbashkëta kurse në vitin e tretë vazhdohet me profilet: **Menaxhim dhe Ndërmarrësi ose Menaxhim i Marketingut dhe Shitjes.**

Studentët përcaktohen orientimisht për profilin e tyre kur të regjistrohen kurse përcaktimin definitiv duhet ta bëjnë kur të regjistrojnë vitin e dytë të studimeve përkatësisht semestrin e III-të. Përmbajtjen e programeve sipas profileve i gjeni në këto linqe:

- **Menaxhim dhe Ndërmarrësi:** <https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2017/06/Programi-i-studimit-Profil-Menaxhim-dhe-Ndermarresi-%E2%80%93-2020-21-deri-2022-23-.pdf>
- **Menaxhim i Marketingut dhe Shitjes:** <https://www.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2017/06/Programi-i-studimit-Profil-Menaxhim-i-Marketingut-dhe-Shitjes-%E2%80%93-2020-21-deri-2022-23-.pdf>

Varësisht nga profilet, Programi përgatitë studentët për tregun e punës duke fituar njohuri, shkathësi dhe kompetenca të listuara në vijim si rezultate të pritura të programit:

1. Njohjen me teoritë dhe konceptet nga fusha e menaxhimit dhe ndërmarrësisë;
2. Njohjen me metodologjitë e trajtimit dhe zgjidhjes së probleme në botën reale;
3. Definimin dhe krahasimin e qartë të natyrës së problemeve dhe gjetjen e metodave përkatëse;
4. Përdorimi i teknikave adekuate për mbledhjen dhe analizën e të dhënave që do të shërbejnë për vendimmarrje;
5. Zbatimi i metodologjive të përshtatshme të zgjidhjes së problemeve menaxheriale në nivelin e ulët dhe të mesëm të menaxhimit;
6. Zbatimi i metodologjive të përshtatshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e ndërmarrësisë dhe bizneseve të reja;
7. Zbatimi i metodologjive të përshtatshme që kanë të bëjnë me marketingun e ndërmarrjeve dhe përballjen me tregun dhe konkurrencën;
8. Konceptet kryesore që mbështesin inovacionin dhe çështjet që lidhen me zhvillimin dhe mbështetjen e inovacionit brenda organizatave;
9. Aplikojnë strategji menaxheriale dhe të marketingut;
10. Analizojnë dhe kategorizojnë qartë problemet e jetës reale të biznesit;
11. Përdorimin e teknologjisë informative në biznes;
12. Asistim të menaxhmentit të lartë në hartimin e strategjive kreative për ndjekjen, shfrytëzimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mundësive të reja;
13. Çështjet që lidhen me sigurimin dhe menaxhimin e burimeve financiare në bizneset e reja.

Pos programeve bashkëkohore, në Fakultetin Ekonomik do të gjeni një staf të përgatitur profesionalisht, si akademik ashtu edhe administrativ, të motivuar për punë që do të jetë në shërbim tuajin për të ju ndihmuar dhe mbështetur në këtë fazë të rrugëtimit tuaj drejt suksesit në karrierë.

Shëndet e suksese!
Mirupafshim!

Dekani
Prof.Ass.Dr.Xhevat Sopi